

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE PËR VITIN 2009

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke konsideruar luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave si një nga sfidat kryesore dhe prioritet e kësaj mazhorance;

- Duke riafirmuar rolin e pazëvendësueshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive në zbulimin, evidentimin, dhe parandalimin e konfliktit të interesave dhe praktikave të pasurimit korruptiv;

- Duke vlerësuar arritjet dhe rezultatet efektive të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive në parandalimin e zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave dhe në zbulimin e fshehjes së pasurisë për vitin 2009;

- Me objektivin që lufta kundër korrupsionit të sjellë rezultate të qarta, të forta e të pakthyeshme, në stabilizimin e plotë të kulturës qeverisëse antikorruptive,

Konstaton për vitin 2009 se ILDKP-ja:

- Ka ushtruar me vendosmëri kompetencat e tij ligjore për dhënien e masave administrative dhe dërgimin e çështjeve në organin e akuzës, në zbatim të ligjit, për zyrtarët që kanë refuzuar deklarimin e interesave privatë, kanë fshehur pasurinë apo kanë bërë deklaram të rremë, si dhe për shkelje të ligjit të parandalimit të konfliktit të interesave;

- Ka dëshmuar një vullnet të mirë dhe është bërë nismëtar për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional me struktura të specializuara e përgjegjëse në luftën kundër korrupsionit e krimit ekonomik, brenda dhe jashtë vendit;

- Ka vazhduar trajnimin me subjektet e parashikuara në ligj, në lidhje me zgjidhjen e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive, duke synuar në këtë mënyrë rritjen e performancës së zyrtarëve të administratës në institucionet qendrore dhe vendore.

Për vitin 2010 kërkon:

- ILDKP-ja të vijojë forcimin e kapaciteteve për administrimin e konfliktit të interesave në institucionet publike;

- Të propozojë ndryshimet e nevojshme në legjislacion për rregullimin e pasojave juridike të shkaktuara nga situatat me konflikt interesi dhe për ndëshkimin e zyrtarëve apo personave të lidhur me ta, përgjegjës për konfliktin e interesit;

- Të forcojë marrëdhëniet publike e të promovojë veprimtarinë e vet, me qëllim sensibilizimin dhe edukimin nëpërmjet shembujve të veprimit të ligjit, si dhe për të rritur besimin e publikut në efikasitetin e mekanizmave të vet antikorruptivë;

- Të kërkojë me më shumë forcë e vendosmëri nga organet e ndjekjes penale procedimin rezultativ të zyrtarëve të zbuluar prej tij në konflikt interesi apo në fshehje të pasurive të tyre;

- Të informojë publikisht ose drejtpërdrejt Kuvendin për rastet kur autoritetet përgjegjëse, respektivisht Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë i Drejtësisë apo Ministria e Drejtësisë neglizhojnë ose kapin rezultate të ulëta në ndjekjen dhe ndëshkimin e konfliktit të interesit apo fshehjes së pasurisë të zbuluar prej tij;

- Të forcojë instrumentet e investigimit administrativ, sidomos në sektorë të jetës publike, ku fenomeni i korrupsionit është më i përhapur dhe besimi i publikut më i ulët;

- Të vijojë forcimin e bashkëpunimit dhe mbështetjes ndaj shoqërisë civile, medias dhe publikut të gjerë për informacionet e dhëna për rastet e denoncimit të shkeljes së ligjit për deklarimin e interesave privatë pasurorë, si dhe për rastet e identifikimit të konfliktit të interesave.

29 prill 2010